

KANUNI PËR GOSTIVARIN

Programi Zgjedhor

ZGJEDHJET LOKALE 2025
KANDIDAT I PAVARUR PËR KRYETAR TË
Komunës së Gostivarit

VISAR ADEMI
“ GOSTIVARI ME
VISARIN”



Me Visarin Për Gostivarin!

Përmbajtja

Fjala Ime Për Ju.....	3
Ta pastrojmë Gostivarin	5
Pastro Administratën nga korrupsioni.....	5
Pastro Gostivarin nga mbeturinat.....	5
Pastro Gostivarin nga qentë endacakë	6
V I Z I O N I.....	7
Sfidat Kryesore	8
Zhvillimi Ekonomik, Punësimi dhe Sipërmarrësia	10
Problemet kryesore	10
5 Projektet e Shtyllës I:.....	13
I. Platforma Më e Madhe e Sipërmarrësisë në Ballkan.....	13
II. Krijimi i një “Endowment Fund” ose Fondi Dhurimi	14
III. Qendra për Mbështetjen e Bizneseve Lokale	14
IV. “GOSTIVAR Connects” - Diaspora Dhuron Dije Jo Para.....	15
V. Krijimi i Techno-Parkut industrial ‘INO-VAR’	15
Arsimi, Shkathësitë dhe Fuqizimi i të Rinjve.....	17
Problemet kryesore	17
5 Projektet e Shtyllës II:	20
I. Platforma më e Madhe për Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor.....	20
II. Edukimi i Transformuar	21
III. Infrastruktura Shkollore dhe Trajnime për Mësimdhënësit.....	22
IV. Organizimi i Mësimi Tërëditor Për Herë Të Parë në Gostivar.....	23
V. Fuqizimi i të Rinjve në Qendër të Zhvillimit të Qytetit.....	23
Transparenca, Digjitalizimi dhe Inovacionet.....	25
Problemet kryesore	25
5 Projektet e Shtyllës III:.....	28
I. Shërbime Digjitale dhe Transparente “e-KOMUNA 2030”.....	28
II. Transformimi Institucional “KOMUNA NË SHËRBIM” :.....	28

III. Transparencë Maksimale “KOMUNA KOMUNIKON”:	29
IV. Transformimi i Ndërmarrjeve Publike në Profitabile:	30
V. Inovacionet e “QYTET I MENÇUR”	30
Planifikim Urban, Arkitektura dhe Infrastruktura.....	31
Problemet kryesore	32
5 Projektet e Shtyllës IV:	35
I. Aprovimi i Planit Gjeneral dhe Planit Detal Urbanistik	35
II. Transformimi në Hapësirë Urbane: “Gostivari i së Ardhmes”	35
III. Përmirësimi i Infrastrukturës Komunale “Jeta me Dinjitet”	37
IV. Qasje e lehtë për të marginalizuarit “Gostivari i të gjithëve”	38
V. Krijimi i Programit “Gostivari Kujdeset”	38
Trashëgimia Kulturore, Turizmi dhe Diaspora.....	40
Problemet kryesore	40
5 Projektet e Shtyllës V:.....	42
I. Mbështetje për Bujqësinë: “Nga Ara në Treg, Gostivari Prodhon!”	42
II. Agro-Turizmi si Destinacion Turistik	43
III. Rigjallërimi i Traditave të Gostivarit	43
IV. Festalet si Koncept Turistik	44
V. Trajnimi dhe Këshillimi i Bizneseve Bujqësore	44
Parimet Themelore:.....	45
Parakushtet për Bashkëqeverisje me Qytetarët.....	46
.....	46
Korniza Ligjore dhe Institucionale.....	46
Ndërtimi i Kapaciteteve.....	46
Mjete dhe Mekanizma	46
Infrastrukturë për Transparencë	46
Si Do Ta Realizoj Programin?.....	47
Thirrje Për Mbështetje	48
Kontakt.....	49

Fjala Ime Për Ju

“ I dashur qytetar i Gostivarit... ”

Kjo nuk është një garë politike për mua. Është një thirrje që më vjen prej zemrës, një përgjegjësi që e ndiej çdo ditë, kur eci nëpër rrugët e këtij qyteti që e dua. Ky qytet më ka rritur, më ka formuar, më ka dhënë gjithçka që jam sot. Dhe tani është radha ime t'i kthej diçka mbrapsht. Sot, më shumë se kurrë, ndiej peshën dhe përgjegjësinë për të qenë zëri i atyre që nuk dëgjoen, shpresa e atyre që janë zhgënjyer, dhe drita e një rruge të re për qytetin tonë të dashur. Kjo kandidaturë nuk buron nga ambicia për pushtet, por nga nevoja për shërbim. Nga dhembja e një qytetari që e sheh qytetin e tij të dashur duke u zbratur nga të rinjtë, duke u rënduar nga mungesa e gjithëpërfshirjes duke u kthyer në pronë e disave dhe përjashtimit të dhjetërave, dhe duke humbur lidhjen me qytetarin e zakonshëm.

Kur shoh të rinjtë që largohen sepse nuk shohin të ardhme këtu, kur dëgjoj prindërit që ndihen të lodhur nga premtimet boshe, kur shoh të moshuarit që nuk kanë nipërit dhe mbesat e tyre afër për ti ledhatuar ato dhe kur takoj qytetarin e zakonshëm që më thonë “*ne kemi humbur besimin*”, unë e di se ka ardhur momenti për të bërë diçka ndryshe. **Jo për pushtet. Por për dinjitet. Për njerëz. Për vendin tonë.**



Nuk kam përgjigje për gjithçka, por kam vullnet, ndershmëri dhe guxim. Dhe mbi të gjitha, nuk jam vetëm - jam me Ju.

Ky program është një reflektim i nevojave tuaja, i ëndrrave të përbashkëta që kemi për një Gostivar që respekton çdo qytetar, që dëgjon, që kujdeset dhe që zhvillohet pa lënë askënd pas.

Nëse më jepni besimin, do të jem zëri juaj në institucionin që sot ndjehet larg, por që nesër do të jetë pranë çdo qytetari.

Me përulësi dhe respekt,

Visar Ademi



Ta pastrojmë Gostivarin

Mjaft më me premtime politike pa asnjë realizim! Për herë të parë ju mund të mbështesni një kandidat për kryetar komune, i cili nuk është pjesë e strukturave politike!

Visar Ademi është i pavarur, nuk i jep llogari askujt tjetër përveç juve, qytetarëve. Ai do ta pastrojë komunën tonë për t'ia kthyer dinjitetin vendlindjes.

Pastro Administratën nga korrupsioni

- ❖ Shkarkimi i të gjithë drejtorëve partiakë si akt i parë
- ❖ Vlerësimi i të gjitha vendeve të punës dhe performancës sipas detyrës së tyre
- ❖ Largimi nga puna i të gjithëve që nuk respektojnë profesionalizmin dhe etikën e punës
- ❖ Përgjysmimi i numrit prej 270 të punësuarve vetëm në Komunë
- ❖ Transformimi i ndërmarrjeve publike në entitete efikase, efektive dhe profitabile
- ❖ Punësime të reja përmes një procesi transparent, jopartiak dhe të bazuar vetëm në profesionalizëm
- ❖ Zyrë Anti-Korrupsion për raportime anonime nga qytetarët

Pastro Gostivarin nga mbeturinat

- ❖ Brenda 7 ditëve do të pastrojmë qytetin dhe fshatrat nga mbeturinat
- ❖ Brenda 7 javësh do të mënjanohej të gjitha deponitë ilegale
- ❖ Investime në makineri të reja dhe forcim të burimeve njerëzore
- ❖ Vendosja e koshave të mbeturinave në të gjithë komunën, me zbrazje të rregullt
- ❖ Vendosja e kamerave dhe ndëshkim i çdo ndotësi

Pastro Gostivarin nga qentë endacakë

- ❖ Të gjithë koshat e mbeturinave do të jenë nëntokësore, pa qasje për qentë
- ❖ Vendosja e pajisjeve moderne me ultratinguj për largimin e qenve nga vendbanimet
- ❖ Angazhimi i kapësve profesionistë për kapjen e qenve potencialisht të rrezikshëm
- ❖ Mbyllja e strehimores skandaloze të qenve dhe ndërtimi i një të reje me standarde ndërkombëtare

Le ta bëjmë ndryshimin të ndodhë me mbështetjen e qytetarëve kundër fuqisë së partive!



V I Z I O N I

Të ndërtojmë një sistem të qeverisjes lokale që është transparent, përgjegjës dhe pjesëmarrës në Komunën e Gostivarit, ku qytetarët nuk janë vetëm përfitues, por partner aktiv në marrjen e vendimeve, planifikimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen,

Komuna do të jetë gjithëpërfshirëse, e përgjegjshme dhe e orientuar drejt qytetarëve, ku çdo qytetar ka të drejtë të ndikojë në politikën dhe buxhetin lokal.



Sfidat Kryesore

10 sfidat dhe problemet kryesore, për të cilat kabineti paraparak kishte premtuar se do t'u kushtonte vëmendje të menjëhershme, por që asnjëherë nuk u zgjidhën dhe sot kanë krijuar një hendek të madh zhvillimi midis Gostivarit dhe qyteteve të tjera në vend dhe rajon.



5 x 5

SHTYLLA

PROJEKTE

= 25

zgjdhje

Shtylla I:

Zhvillimi Ekonomik, Punësimi dhe Sipërmarrësia

Zhvillimi ekonomik i Gostivarit është çelësi për një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët tanë. Qyteti ynë ka potencial të madh: nga pozita e favorshme gjeografike, diaspora aktive dhe sipërmarrësia e trashëguar “kodi gjenetik i gostivarasve”, deri te rinia e talentuar dhe pasuritë natyrore. Megjithatë, ky potencial nuk është shfrytëzuar mjaftueshëm; ai duhet të shndërrohet në politika të qarta dhe veprime konkrete që sjellin mirëqenie për të gjithë.

Gostivari ka nevojë për një kthesë të re; një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik që nuk varet nga premtime bosh, por nga politika të mençura dhe veprime të matshme. Zhvillimi ekonomik, punësimi dhe sipërmarrësia nuk janë vetëm fjalë - janë rruga për të kthyer shpresën, për të mbajtur të rinjtë këtu dhe për ta bërë Gostivarin një vend ku ia vlen të jetosh e të investosh.

Problemet kryesore

- ❖ Gostivari ka qenë një ndër vendet me tregti më të zhvilluar në rajon, me një ekonomi të bazuar kryesisht në bizneset familjare. Sot, ai e ka humbur pozicionin e tij konkurrues krahasuar me ekonomitë e tjera lokale dhe mbijeton pothuajse ekskluzivisht falë remitançave të diasporës, të cilat arrijnë rreth 15.000.000 EUR në vit, ose afërsisht 300 EUR për frymë banori.
- ❖ Përveç remitançave, diaspora kontribuon në ekonominë e Gostivarit edhe përmes investimeve kapitale në shtëpi, banesa dhe dasma duke harxhuar rreth 1 miliard euro në vit. Kjo është një nga burimet kryesore të jetës ekonomike të qytetit dhe bën që bizneset e vogla dhe familjare të mbijetojnë pothuajse ekskluzivisht nga kontributi sezonal i diasporës. Për shkak të remitançave dhe kthimit të gurbetqarëve, Gostivari është kthyer në një qytet sezonal, me aktivitet ekonomik të dukshëm vetëm dy herë në vit: rreth 20 ditë në verë dhe 10 ditë në dimër.

- ❖ Ndërkohë, modeli ekonomik i qytetit është i orientuar drejt sektorëve me investime kapitale që kanë pak ose aspak ndikim në mirëqenien e qytetarëve, si ndërtimi dhe industrinë e ahengut. Gostivari shpenzon rreth 500 milion Euro në dasma dhe evente festive, si dhe investon në afërsisht 400 banesa me një sipërfaqe totale prej 32,000 m² dhe me vlerë ekonomike prej rreth 32 milion Euro në vit. Megjithatë, vetëm 75% e këtyre banesave janë të pabanueshme, dhe vetëm 100 prej tyre janë të banueshme me familje me banorë.”
- ❖ Sot, Gostivari nuk ka asnjë brand të njohur, që të ketë fuqi të madhe për punësim, zhvillim ekonomik dhe tërheqje investimesh kapitale. Ndërkohë, qytetet e tjera jo vetëm që kanë brandet e tyre, por i kanë eksportuar ato edhe jashtë vendit, duke përfituar nga potenciali që ne nuk e shfrytëzojmë.
- ❖ Ekonomia e qytetit bazohet kryesisht në hapjen e zinxhirëve tregtarë për ushqime, të cilat nxjerrin paratë e gatshme nga qyteti, në bizneset familjare të vogla që mbijetojnë vetëm për nevojat e tyre, dhe në investime në sektorë me pak vlerë shoqërore, si dasmat dhe ndërtimtaria, ku paratë përfitojnë kryesisht elitat ekonomike.
- ❖ Potenciali i Gostivarit për zhvillimin e agro-turizmit dhe kapaciteteve bujqësore është i madh, pasi fusha e Pollogut ishte e treta në ish-Jugosllavi për nga potenciali në prodhimin e produkteve ushqimore. Megjithatë, sot ajo është kthyer në një zonë të mbingarkuar me automjete, deponi kolektive dhe salla dasmash.
- ❖ Modeli i udhëheqjes komunale bazohet në fuqizimin e sektorit publik, me shpenzime dhe kosto që mbulohen nga sektori privat. Duke marrë parasysh se sektori publik përbën rreth 70% të të gjithë punësimit në qytet (bazuar në raportimet për dominancën e arsimit, administratës dhe shërbimeve publike), rezulton se nga 16,000 punëtorë, rreth 11,200 punësohen në sektorin publik.
- ❖ Ndërkohë, sektori privat ka të punësuar rreth 6,100 persona, që do të thotë se për çdo punonjës në sektorin privat, sektori publik mban rreth 1 punonjës, ose proporcionalisht 0.54:1. Kjo është jashtë çdo logjike, pasi konkurrenca më e madhe për punësime duhet të jetë brenda sektorit privat. Po ashtu, kjo tregon nivele të ulëta dhe të pabarabarta në mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tatimet.
- ❖ Pa dyshim, të gjithë qytetet e Maqedonisë kanë humbur një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, por Gostivari është kampion absolut në ‘ikjen e trurit’, me mbi 30,000 njerëz, ose 37% të popullsisë së tij vitale. Ky imigrim ka

një kosto të madhe, jo vetëm ekonomike, por edhe shpirtërore. Sipas OECD, shpenzimet private dhe shoqërore për rritjen e një të riu, nga lindja deri në moshën 21 vjeç, arrijnë rreth 120,000 USD në Amerikë dhe 150,000 Euro në Europë, ndërsa tek ne janë rreth 50,000 Euro. Kjo do të thotë që, si qytetarë të Gostivarit, nga ikja e trurit kemi humbur rreth 1.5 miliard Euro, ose 75 milion Euro në vit gjatë 20 viteve të fundit. Në këtë llogaritje nuk përfshijmë produktivitetin, kontributin shoqëror dhe shpenzimet e jetës nëse ata do të ishin ende në Gostivar, të cilat e rrisin edhe më shumë koston.

- ❖ Gostivari, në periudhën më të mirë të tij, ka fituar grante prej vetëm 5 milion Euro për një mandat politik të kryetarit, ndërkohë që fondet e huaja dhe grantet e dedikuara për Maqedoninë arrijnë 1.3 miliard Euro për ndihmë bilaterale (IPA dhe IPARD) dhe 5 miliard Euro ndihmë multilaterale për zhvillim institucional, përmirësim të shërbimeve publike dhe ngritjen e kapaciteteve të ekonomisë lokale. Kapacitetet e ulëta për identifikimin, tërheqjen dhe menaxhimin e këtyre fondeve kanë bërë që qyteti të jetë ndër vendet me më pak grante për frymë banori në Maqedoni.

5 Projektet e Shtyllës I:

Zhvillimi Ekonomik, Punësimi dhe Sipërmarrësia



I. Platforma Më e Madhe e Sipërmarrësisë në Ballkan

1.1 Gostivar Start-Up Hub.

Në partneritet me biznesin privat, do të ndërtohet hapësira më e madhe në Ballkan për sipërmarrësit dhe start-up-et, e cila do t'u mundësojë të rinjve, për një periudhë 6-mujore deri në 1 vit, që pa asnjë kompensim monetar të përdorin hapësirat për të testuar idetë e tyre të biznesit. Ata do të kenë falas qiranë e hapësirave fizike, internetin dhe të gjitha shpenzimet operative të mbuluara nga Komuna, me qëllim që Gostivari të bëhet platforma më e madhe e krijimit të bizneseve të reja.

1.2 "Gostivari Ecen Shpejt"

Akseleratori më i madh në vend. Gjatë kësaj periudhe do të krijojmë Akseleratorin më të madh, i cili do të ofrojë trajnime, mentorime dhe këshillime për të mbështetur sipërmarrësit që idetë e tyre të biznesit të kenë sukses. Qëllimi është të hapen sa më shumë biznese në Gostivar, të krijohen vende pune dhe të sigurohet mirëqenie për qytetarët, duke orientuar zhvillimin e qytetit drejt sektorit privat dhe jo atij publik. Sepse zhvillimi ekonomik që bazohet në krijimin e bizneseve dhe fuqizimin e sektorit privat sjell qëndrueshmëri dhe zhvillim afatgjatë.

Ky Akselerator do të jetë i hapur si për sipërmarrësit e rinj, ashtu edhe për kompanitë ekzistuese. Ai do të ofrojë trajnime, mentorime dhe këshillime nga ekspertë të fushës, duke u dhënë sipërmarrësve mbështetjen e nevojshme dhe fokusin për zhvillimin e ideve të tyre. Pas përfundimit të periudhës së qirasë

njëvjeçare, sipërmarrësit do të dalin në tregun komercial, duke liruuar vendin për gjeneratën e re që do të vijë rishtazi në qendër.

1.3 “Engjëjt e Gostivarit” - Program për financimin e start-up-eve.

Komuna do të krijojë një platformë digjitale ku mërgimtarët (gurbetqarët) do të kenë mundësi të shohin projekte konkrete për investime në zhvillimin lokal dhe në start-up-et kreative të të rinjve të Gostivarit. Çdo tre muaj do të organizohet një ngjarje rrjetëzimi, ku do të ftohen të gjitha rrjetet e ‘Engjëjve të Biznesit’ në vend dhe në diasporë, të cilët kanë kapital dhe dëshirë të investojnë në start-up-e apo ide të reja biznesi. Këtu ata do të takohen drejtpërdrejt me sipërmarrësit e rinj për të diskutuar mundësitë e bashkëpunimit dhe partneritetit.

II. Krijimi i një “Endowment Fund” ose Fondi Dhurimi

Krijimi i një “Endowment fund” ose Fond Dhurimi në bashkëpunim me Diasporën për investime kapitale dhe projekte zhvillimore ka për qëllim të grumbullojë kapitalin nga investitorët e diasporës, por edhe nga bizneset vendore. Pasi të marrë formën e tij, fondi do të ndajë aksionet në përputhje me shumën e investuar dhe më pas këto mjete do t’i besohen një fondi investiv ndërkombëtar, i cili do t’i investojë në mekanizma të ndryshëm financiarë në tregjet botërore. Fitimi që do të gjenerohet nga këto investime, në formën e interesave, do të përdoret për projekte dhe investime në shërbimet komunale, duke krijuar kështu një *‘Fond Zhvillimor Lokal’*.

2.1 “Fondi Zhvillimor Lokal”

Fondi zhvillimor lokal do të financojë projekte të infrastrukturës lokale dhe projekte sociale, duke siguruar transparencë të plotë.

III. Qendra për Mbështetjen e Bizneseve Lokale

Kjo qendër do të funksionojë në kuadër të Zhvillimit Ekonomik Lokal dhe ka për qëllim të organizojë trajnime për rritjen e konkurrueshmërisë së kompanive lokale, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të tyre përmes pjesëmarrjes së organizuar në panaire lokale dhe rajonale, me qëllim promovimin e brandit ‘*Made in Gostivar*’. Gjithashtu, qendra do të lidhë sektorin privat me fondet dhe grantet ndërkombëtare për zhvillim biznesi. Komuna do të bashkëpunojë ngushtë me sektorin privat në identifikimin e problemeve të përbashkëta, përmes mekanizmit të Këshillit të Bizneseve dhe Esnafeve të Gostivarit, i cili do të luajë rol kyç në evidentimin e sfidave dhe çështjeve të sektorit privat.

IV. “GOSTIVAR Connects” - Diaspora Dhuron Dije Jo Para

4.1 “Mentorë nga Diaspora”

Program që i lidh të rinjtë e Gostivarit me ekspertë nga diaspora që kanë eksperiencë ndërkombëtare, duke u bërë mentorë në fusha të ndryshme si *biznes, inovacion, teknologji dhe sipërmarrje sociale*.

4.2 Eventi “Ditët e Diasporës në Gostivar”

Organizim i ngjarjeve vjetore për rikthimin e diasporës në qytet, përfshirë panaire biznesi, prezantime të projekteve kreative të të rinjve dhe mundësi konkrete për investime.

V. Krijimi i Techno-Parkut industrial ‘INO-VAR’

Komuna ka identifikuar disa lokacione, si Garnizoni Ushtarak, për krijimin e investimeve në kompani me bazë financiare të madhe ose industri përfshirëse, si dhe investime të huaja që kanë fuqi të madhe absorbuese dhe kërkojnë kapital të konsiderueshëm. Këto investime do të vendosen në zona të veçanta industriale, afër rrugëve kryesore, me qëllim që distribuimi i produkteve dhe shërbimeve të bëhet më shpejt dhe më efikas.

5.1 “Investo në Gostivar”

Lehtësime fiskale dhe administrative për investitorët lokalë dhe rajonalë që punësojnë të rinjtë dhe kontribuojnë në zhvillimin ekonomik.

Shtylla II:

Arsimi, Shkathësitë dhe Fuqizimi i të Rinjve

Nelson Mandela ka thënë: „ *Arsimi është arma më e fuqishme që mund të përdoret për të ndryshuar botën.*” Gostivari është një qytet i ri nga ana e moshës së popullsisë, por të rinjtë tanë shpesh ndihen të harruar. Ata përballen me një sistem arsimor të totalisht të partizuar, me mësues dhe arsimtarë pa trajnim të mjaftueshëm, dhe me nxënës që rrallëherë përgatiten për tregun e punës. Mungesa e mundësive për zhvillim personal dhe klima e mbështetur mbi konflikte politike i shtyn ata të mendojnë për largim. Nëse duam një Gostivar që ecën përpara, duhet të vendosim arsimin dhe fuqizimin e të rinjve në qendër të vizionit tonë për të ardhmen.

E vetmja fushë me të cilën nuk do të bëj kompromis për rezultatet që dua të arrij nga programet nën qeverisjen tonë është arsimi. Arsimi nuk mund të jetë vetëm formalitet; ai duhet të jetë praktik, cilësor dhe i fokusuar në nevojat reale të tregut të punës dhe të jetës moderne. Duhet të mbështeten programet që zhvillojnë aftësi teknologjike, digjitale, gjuhësore dhe sipërmarrëse, në bashkëpunim me shkollat, shkollat e mesme profesionale, universitetet dhe sektorin privat.

Nëse sot investojmë në arsimin cilësor dhe zhvillimin e aftësive, nesër do të kemi qytetarë aktivë, profesionistë të aftë dhe liderë të rinj që do ta çojnë Gostivarin përpara.

Problemet kryesore

❖ **Informata të pamjaftueshme për kapitalin njerëzor në Gostivar:**

Qyteti nuk ka një bazë të dhënash ose informacion mbi kapitalin njerëzor, duke filluar nga kualifikimet, zanatet, profesionet, aftësitë dhe kompetencat e të rinjve në Gostivar. Sot, nëse vjen një kompani e huaj ose ndonjë kompani e madhe vendore dhe pyet Komunën për resurset humane, asnjë departament në Komunë nuk mund të japë të dhëna të sakta mbi nivelin arsimor të të rinjve, profesionet më të zakonshme, ato deficitare, kualifikimet ekzistuese dhe

njohuritë që mungojnë. Këto të dhëna janë shumë të rëndësishme për të planifikuar zhvillimin tonë shoqëror dhe ekonomik, por pa informacion adekuat, kjo bëhet e pamundur.

❖ **Infrastruktura mesjetare:**

Sot, çdo shkollë fillore dhe e mesme në Gostivar vuan nga kushtet mesjetare që ekzistojnë në institucionet arsimore. Kjo ndikon jo vetëm në mbarëvajtjen e procesit mësimor, por edhe ambientet e tjera të shkollës nuk plotësojnë kushtet minimale higjienike.

Për më tepër, në shumë shkolla, si ajo industriale, zyrat dhe pajisjet janë të pamjaftueshme, makineritë janë të vjetruara dhe zbatimi i projekteve është i ngadaltë. Infrastruktura dixhitale e shkollave është thuajse e papërfaqësuar, duke treguar se akoma mbetemi prapa në procese që janë të domosdoshme për të ngritur cilësinë e arsimit dhe kompetencat e nxënësve në Gostivar.

❖ **Ndërlidhja e arsimit me ekonominë lokale:**

Sfida më e madhe me të cilën përballen shkollat e mesme profesionale është të mbajnë hapin me tregun e punës, i cili ndryshon me shpejtësi. Kompanitë presin që studentët tanë të jenë plotësisht të përgatitur me aftësitë specifike të nevojshme për punët e tyre. Megjithatë, kërkesat e industrisë evoluojnë vazhdimisht, veçanërisht me një fokus në rritje mbi aftësitë dixhitale dhe teknologjitë e reja.

❖ **Orientimi në karrierë nuk ekziston:**

Një i ri që përfundon shkollën fillore ose të mesme mbetet i lënë vetë të marrë vendime për zanatin, profesionin dhe karrierën e tij, gjë që shpesh përfundon me zgjedhje të gabuara. Të rinjtë janë viktima e vendimeve të marrë nga shoqëria e tyre e ngushtë ose preferencat e prindërve, të cilat zakonisht mund të çojnë në një orientim të pasaktë në karrierë dhe mundësi të humbura për zhvillim profesional.

❖ **Mundësi të limituara për të rinjtë për shkak të politizimit dhe partizimit gjatë punësimit:**

Sipas të dhënave zyrtare nga Agjencia e Punësimit, deri më 31 dhjetor 2021 në Gostivar ishin të regjistruar 9.531 persona të papunë, duke e renditur qytetin në vendin e katërt në nivel republikan pas Shkupit, Kumanovës dhe Tetovës për nga numri i të papunëve.

Për më tepër, tregu i punës në Gostivar paraqet shifra alarmente: deri në 25% e qytetarëve nuk janë aktivë në tregun e punës. Ata nuk janë as në arsim, as në trajnime dhe as në punësim, gjë që është shqetësuese pasi ky grup përfiton shërbime shoqërore dhe komunale, por mbetet totalisht i pintepruar në tregun e punës.

❖ **Sistem që nuk mbështet mësimdhënësin:**

Sistemi arsimor nuk investon as tek fëmijët, as tek mësimdhënësit, duke mos i trajnuar ata me metodat më të reja pedagogjike, trajnime profesionale në lëndët përkatëse, apo aftësi të buta dhe komunikimi. Kjo ka për pasojë që mësimdhënësit nuk janë të përgatitur për të prodhuar gjeneratën e re të kapitalit njerëzor në Gostivar.

❖ **Vlerësimi i mësimdhënësve:**

Qyteti nuk aplikon një sistem vlerësimi të mësimdhënësve, i cili është i domosdoshëm për të pasur mësimdhënës të motivuar, të orientuar drejt suksesit dhe zhvillimit të metodave pedagogjike bashkëkohore.

❖ **Qëndrueshmëria e institucioneve arsimore:**

Shkollat komunale janë institucione që financohen nga Ministria e Arsimit për pjesën e mësimdhënies, por ato sigurojnë edhe një pjesë të të ardhurave zakonisht nga dhënia me qira e faciliteteteve të shkollës, si sallat sportive. Megjithatë, këto mjete shpesh keqpërdoren për financime partiake.

5 Projektet e Shtyllës II:

Arsimi, Shkathësitë dhe Fuqizimi i të Rinjve



I. Platforma më e Madhe për Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor

Kjo do të jetë risia më e madhe që është zbatuar ndonjëherë në Maqedoni dhe që do të reformojë tërësisht sistemin arsimor, si dhe zhvillimin e gjeneratës së re, të formuar dhe të zhvilluar pikërisht në Gostivar. Çfarë do të bëjmë?

1.1 Çerdhet

Do të fillojmë që nga çerdhet, me ftesën e folësve mysafir, të cilët mund të jenë prindër të fëmijëve ose të tjerë. Një herë në javë, ata do të shpjegojnë me gjuhën e fëmijëve rolin e profesionistëve të ndryshëm, si mjeku, elektrikisti, ekonomisti, etj.

1.2 Kurset intelektuale dhe sportive në shkollën fillore

Në shkollën fillore do të ftojme të gjitha organizatat që ofrojnë kurse për ngritjen e kompetencave dhe njohurive në Gostivar, për të ofruar kurse të specializuara pas mësimi. Nxënësit do të mund të zgjedhin kurse nga fusha e STEM-it, drama, poezi, ose kurse gjuhësore, me qëllim që fëmijët të jenë më të përgatitur për sfidat e ardhshme.

Po ashtu, do të lidhim të gjitha akademitë sportive në Gostivar: *futboll, basketboll, hendboll, tenis dhe sporte të tjera* që fëmijët të mund të zhvillojnë aftësi fizike dhe

të plotësojnë kurset e zhvillimit intelektual. Fëmijët do të zgjedhin kurset së bashku me prindërit e tyre.

Pasi të jenë zgjedhur kurset, Komuna do të zhvillojë një softuer që do të ndjekë zhvillimin e fëmijës në të gjitha fazat dhe etapat, duke informuar edhe prindërit mbi progresin e fëmijës së tyre. Në fund, Komuna, së bashku me ofruesit e kurseve, do të japin certifikata për plotësimin e kushteve nga nxënësi.

Në shkollën e mesme, do të bëjmë lidhjen e mësimit me punën praktike në kompani, duke bërë që nxënësit të njohin kompanitë, të përvetësojnë kulturë dhe shprehi pune, dhe të kuptojnë më mirë profesionin e tyre të ardhshëm.

1.3 “Fond për talentët e Gostivarit”

Mbështetje financiare vjetore për 20 të rinj të talentuar, përfshirë trajnime, kurse të specializuara, studime jashtë vendit, si dhe ndihmë monetare.

II. Edukimi i Transformuar

2.1 Krijimi i shkollave të qëndrueshme:

Në partneritet me fondet e huaja ose kompani private, të gjitha facilitetet e shkollës do të jepen me koncesion. Operatori privat do të mund të japë me qira sallat sportive, të instalojë kolektorë solarë dhe të shesë energji elektrike institucioneve përreth. Gjithashtu, do të futet në partneritet me Komunën, ku gjysma e këtij profiti do të investohet në shkollë për renovimin e pajisjeve dhe krijimin e shkollave të mençura për gjeneratën e re të kapitalit njerëzor.

2.2 Bashkëpunimi me organizata vullnetare dhe ambasada të huaja për mbështetje profesionale në arsimin e transformuar:

Do të bëjmë marrëveshje me organizata vullnetare, siç është VSO nga Britania, dhe do të kërkojmë të sjellim mbështetje profesionale nga profesionistë ose pensionistë që kërkojnë sfida të reja. Ata do të ndihmojnë udhëheqjen e shkollave fillore dhe të mesme, me qëllim krijimin e një modeli inkluziv të arsimit, që shërben për përmirësimin e cilësisë, adresimin e nevojave të shoqërisë dhe përgatitjen për tregun e punës.

2.3 Kurikula të reja në bashkëpunim me sektorin privat:

Sipas analizave të tregut të punës dhe në bashkëpunim me kompani të orientuara drejt dijes, do të kërkojmë licencimin e programeve të reja mësimore, që reflektojnë nevojat e kompanive për fuqi punëtore të aftë dhe të punësueshme.

2.4 “Klasa digjitale në çdo shkollë”

Përmirësimi i teknologjisë në shkolla, duke futur mësimin digjital në çdo klasë dhe duke siguruar trajnime për mësimdhënësit.

III. Infrastruktura Shkollore dhe Trajnime për Mësimdhënësit

3.1 Formimi i ‘Kabineteve të zgjuara dhe të gjelbërta’ (Smart & Green Cabinets)

Përmirësimi i teknologjisë në shkolla, duke futur mësimin digjital në çdo klasë dhe trajnime për mësimdhënësit. Shkollat tona do të jenë ndër të parat që krijojnë një mjedis identik me atë të kompanive brenda ambienteve të tyre, duke mundësuar që nxënësit të mësojnë dhe provojnë aftësitë që do të kërkojnë në të ardhmen, në një mjedis të njohur.

Është e rëndësishme që makinat dhe pajisjet në këto kabinete të ndjekin “*agjendën e gjelbër*” të Kombeve të Bashkuara, sepse qëndrueshmëria, si mjedisore ashtu edhe financiare, është baza e çdo ekonomie moderne dhe të suksesshme.

3.2 Investime në kapacitetet e mësimdhënësve:

Ofrimi i mundësive për zhvillim të vazhdueshëm profesional për mësuesit është një parakusht themelor që ata të përditësojnë vazhdimisht njohuritë dhe aftësitë e tyre, duke ndjekur trendet e industrisë dhe metodologjitë moderne të mësimdhënies.

3.3 “Laboratori i aftësive”

Hapja e laboratorëve të rinj të pajisur për shkollat profesionale në fushat e teknikës, mekanikës, gastronomisë, IT-së dhe shëndetësisë.

IV. Organizimi i Mësimit Tërëditor Për Herë Të Parë në Gostivar

Organizimi i mësimit tërëditor *“Nxënës të sigurt, prindër të qetë”* do të realizohet për herë të parë në Gostivar. Nxënësit qëndrojnë në shkollë deri në pasdite, duke ndjekur aktivitete mësimore dhe jashtëshkollore. Komuna siguron drekat falas, hapësira të reja dhe kushte komode. Programi përfshin sport, kulturë dhe inovacion, duke zhvilluar shkathtësitë dhe talentin e nxënësve dhe duke lehtësuar prindërit gjatë orëve të punës.

V. Fuqizimi i të Rinjve në Qendër të Zhvillimit të Qytetit

5.1 “Gostivari lexon”

Program për promovimin e leximit në shkollat fillore: dhurim librash dhe krijim këndesh leximi në çdo shkollë

5.2 “Qendra Rinore e Gostivarit”

Fuqizimi i qendrës multifunktionale rinore, ku ofrohen trajnime, këshillime profesionale, programe sociale dhe mbështetje psikologjike. Do të krijojmë partneritete me bizneset lokale për të ofruar njohuri dhe përvoja reale për mësuesit, udhëtime studimore dhe vizita në kompani dhe institucione arsimore brenda dhe jashtë vendit, si dhe pjesëmarrje në panaire, prezantime teknologjish dhe konferenca. Investimi në mësimin digjital për mësuesit është pjesë kyçe e këtij programi.

5.3 Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies

Por me investimet në dije vijnë edhe përgjegjësi. Në fund të çdo viti akademik do të bëhet vlerësimi 360° i mësimdhënësve, duke marrë parasysh opinionet e nxënësve, prindërve dhe kolegëve. Nëse identifikohen performanca të dobëta,

mësuesit do t'u përgatitet një raport për përmirësim, i cili do të monitorohet nga drejtori i institucionit ku punon.

Shtylla III:

Transparenca, Digjitalizimi dhe Inovacionet

Gostivari ka nevojë për një mënyrë të re qeverisjeje të bazuar në besim, efikasitet dhe ide inovative. Transparenca, digjitalizimi dhe inovacioni janë mjetet për të ndërtuar një komunë që i shërben qytetarit, jo që e lodh atë.

Transparenca siguron që qytetari të dijë çdo gjë për buxhetin, projektet dhe vendimet publike. Një komunë transparente publikon çdo kontratë, tender dhe plan investimi në mënyrë të hapur dhe të kuptueshme, duke parandaluar keqpërdorimet dhe duke ndërtuar besim të ndërsjellë mes qytetarit dhe institucioneve. Digjitalizimi shmang burokracinë, radhët e gjata dhe vonesat e panevojshme. Një qytetar i Gostivarit nuk duhet të humbë kohë për të marrë një certifikatë, leje ndërtimi apo dokument tjetër bazik të gjitha këto mund dhe duhet të jenë online, me një klikim të vetëm. Kjo është qeverisje moderne dhe është e mundur, nëse ka vullnet.

Gostivari mund të bëhet shembull i qeverisjes së mirë por kjo kërkon hapje, guxim dhe ide të reja. Transparenca garanton ndershmëri, digjitalizimi sjell efikasitet, dhe inovacioni nxit zhvillimin. Së bashku, këto krijojnë një komunë moderne që respekton kohën, paratë dhe inteligjencën e qytetarëve të saj.

Problemet kryesore

- ❖ Borxhi publik i Komunës gjatë 10 viteve të fundit ka arritur në 25 milionë Euro, bashkë me ndërmarrjet publike, një shifër rekord. Vetëm për dy mandate të kësaj qeverisjeje lokale, borxhi është rritur 8 herë. Kjo do të thotë se secili prej nesh, përveç borxheve dhe kredive private që marrim për të mbijetuar, paguan edhe rreth 490 Euro për frymë banori ose rreth 2,500 Euro për familje.
- ❖ Sipas të dhënave jozyrtare, Komuna e Gostivarit dhe ndërmarrjet publike kanë të punësuar mbi 500 persona me kontratë në vepër, shumica prej tyre militantë partiakë, pa angazhim konkret në institucion. Fatura që paguajmë ne qytetarët për këto punësime arrin në 3 milionë Euro në vit, ose 12 milionë Euro për 4 vite shifër që përbën 50% të vlerës së borxhit publik.

- ❖ Të gjitha ndërmarrjet publike nën menaxhimin e Komunës punojnë me humbje. Një absurditet ekonomik i paprecedentë sepse edhe pse gëzojnë pozicion monopol në treg, pra ofrojnë shërbime që qytetarët patjetër i përdorin, sërish rezultojnë me minus. Për ilustrim: vetëm Komuna e Gostivarit ka një borxh publik prej 18 milionë Euro; NP Komunalec ka akumuluar borxh prej 7 milionë Euro; ndërsa NP Parkingu dhe Gjelbërimi rreth 100.000 Euro. Në total, shuma arrin në rreth 25 milionë Euro që i bie rreth 500 Euro për kokë banori, duke e bërë Komunën e Gostivarit një nga institucionet me borxh më të madh publik në vend.
- ❖ Shërbimet e kontraktuara nga kompani private: Outsourcing-u është modeli që ka ndjekur Komuna e Gostivarit përmes NP Parkingu dhe Gjelbërimi. Për shembull, bashkëpunimi me kompani private si Telekomit dhe një kompani e IT-së, e cila menaxhon rreth 80% të operacioneve që lidhen me parkingjet (si porositi me SMS apo shitja e biletave nga operatorë privatë), ka sjellë një situatë ku ndërmarrja është bërë jo-efektive dhe jo-efikase. Përkundër faktit që ka mbi 50 të punësuar në zyrë, ndërmarrja nuk arrin të arkëtojë të ardhurat që i takojnë.
- ❖ Para të pa-arkëtuara: Ndërmarrja është futur në marrëdhënie kontraktuale ku mbi 80% e shërbimeve kryhen nga operatorë privatë, ndërsa vetë ndërmarrja mbetet vetëm me hapësirën lokale si aktivitet kryesor. Si rezultat, ajo arrin të sigurojë vetëm rreth 10% të të hyrave nga shërbimet që duhej t'i ofronte vetë.
- ❖ Pagesa e ulët nga lejet e ndërtimit dhe shërbimet komunale: edhe pse Gostivari është një nga qytetet me numrin më të madh të lejeve të dhëna për ndërtim, të hyrat reale nga këto leje nuk kalojnë më shumë se 40% të vlerës së përgjithshme. Kjo i shkakton Komunës një humbje financiare prej rreth 400.000 Euro, para të pa-arkëtuara si pasojë e menaxhimit të dobët të mbledhjes së të hyrave që i takojnë Komunës.
- ❖ Mos-grumbullimi i tatimit në prone: Komuna e Gostivarit ka një nivel shumë të ulët të arkëtimit të tatimit në pronë, për shkak të mungesës së vullnetit dhe kapaciteteve njerëzore për ta mbledhur atë. Në vend që të krijojë mekanizma efikasë, Komuna e ka lënë këtë proces në "vullnetin e mirë" të qytetarëve, duke humbur miliona Euro që i takojnë buxhetit lokal.
- ❖ Transparencë Zero e informacionit ndaj qytetarët. Përveç NP Komunalec, asnjë ndërmarrje publike në Gostivar nuk ka faqe zyrtare, platformë informimi apo raport financiar dhe operativ për punën e realizuar gjatë vitit kalendarik. Është

pothuajse e pamundur të gjesh të dhëna mbi numrin e të punësuarve me kontratë, situatën financiare apo aktivitetet operative. Kjo mungesë totale transparence tregon jo vetëm paaftësi menaxhuese, por edhe mungesë të vullnetit politik për t'i dhënë qytetarëve llogari për paratë e tyre.

- ❖ Digjitalizimi dhe aplikimet online në Komunën e Gostivarit lënë shumë për të dëshiruar. Teknologjia informative nuk është luks, por një domosdoshmëri për të shmangur radhët e gjata, humbjen e kohës në sportele dhe stresin e panevojshëm që kërkon prezencë fizike. Platformat aktuale ose janë krijuar nga institucione të tjera jashtë komunës, si ZELS, ose janë pothuajse të paarritshme për përdoruesit që tentojnë t'i qasen me një klikim.
- ❖ Komuna duhet të ketë procesin e dixhitalizimit nën kontroll të saj, për të garantuar sigurinë dhe ndjeshmërinë e të dhënave të qytetarëve, si dhe arkivimin e duhur të dokumenteve.

5 Projektet e Shtyllës III:

Transparenca, Digjitalizimi dhe Inovacionet



I. Shërbime Digjitale dhe Transparente “e-KOMUNA 2030”

1.1 Aplikime për dokumente administrative:

Mundësi për aplikime online për leje ndërtimi, çertifikata lindjeje, çertifikata martesash, dokumente identiteti dhe shërbime të tjera komunale.

1.2 Pagesa online për shërbimet komunale:

Mundësi për pagesa online për taksa, drita, ujë, gjoba, leje aktiviteti etj. Do të rrisim pagesat për lejet e ndërtimit dhe tatimet e pronës në mënyrë të drejtë, duke bërë që Komuna të mos jetë pronë e individëve të fuqishëm, por e qytetarëve.

1.3 Licencime dhe leje:

Për bizneset (licenca, ndërtimet dhe aktivitete të tjera rregullative) do të krijohet një platformë online ku qytetari mund të aplikojë dhe të ndjekë të gjithë procesin e lëndës së tij/saj, duke parë në çfarë faze ndodhet. Do të vendosim standarde për përgjigjet e komunës dhe sanksione për vonesat në dhënien e dokumenteve.

II. Transformimi Institucional “KOMUNA NË SHËRBIM” :

Komuna është institucion intelektual që zhvillon dhe jep shërbime, dhe si e tillë duhet të bëjë transformimin e saj institucional dhe organizativ konform këtij vizioni për 10 vitet e ardhshme. P.sh. Zyra e Zhvillimit Ekonomik Lokal do të ri-organizohet me një drejtori të përgjithshme, e cila do të ketë 3 departamente: e para, konkurrueshmërinë e kompanive lokale; e dyta, do merret me tërheqjen e fondeve të huaja dhe grantet; dhe e treta, me start-up-et dhe sipërmarrësinë. Të gjithë këta do të kenë menaxher ose koordinator të departamentit, i cili do t'i japë llogari drejtorit të sektorit, i cili do të krijojë një vizion të ri për Gostivarin dhe zhvillimin ekonomik të tij.

Për më tepër, do të krijohet një sistem motivimi për punonjësit, i cili fokusohet në një kombinim të shpërblimit fiks (paga e kontraktuar) dhe pagesës variable, e cila do të lidhet me qëllimet dhe rezultatet e pritshme sipas pozicionit të punonjësit. Në fund të vitit do të bëhet vlerësimi i performancës së secilit individ, ku ai/ajo do të vlerësohet nga qytetari, kolegët dhe eprori i tij/saj. Nëse vlerësimet janë pozitive dhe tejkalojnë pritshmëritë, do të propozohet një shpërblim monetar, në përputhje me vendimet e marra për këtë. Në rast se vlerësimet janë negative, individit do t'i krijohet një plan individual për përmirësim, duke përfshirë trajnime dhe mentorime të nevojshme. Nëse kjo situatë përsëritet edhe vitin e dytë, punonjësit i jepet një paralajmërim për largim nga puna. Nëse vitin e tretë nuk ka përmirësime, personi largohet përfundimisht nga puna, duke lënë vend për njerëz të tjerë.

III. Transparencë Maksimale “KOMUNA KOMUNIKON”:

Është e papranueshme që edhe në vitin 2025 seancat e Këshillit Komunal të mos transmetohen drejtpërdrejt në platformën online të Komunës, ose në ndonjë vend ku qytetarët mund të shohin vendimet dhe diskutimet që bëhen në emër të tyre.

Aq më tepër kur shumica e platformave ekzistuese nuk funksionojnë. Unë do të krijoj të gjitha platformat e nevojshme web dhe do të siguroj komunikimin e plotë të lajmeve, vendimeve dhe aktiviteteve të ndërmarrjeve publike; një detyrim që nuk duhet të jetë opsional, por i detyrueshëm.

IV. Transformimi i Ndërmarrjeve Publike në Profitabile:

Ndërmarrjet publike duhet të drejtohen nga menaxherë dhe profesionistë të kualifikuar në fushën përkatëse, jo nga militantë partiakë. Ne do të rivendosim konkursin publik si institucionin kryesor të meritokracisë, ku vendosin aftësitë dhe rezultati mbi përkatësinë politike.

V. Inovacionet e “QYTET I MENÇUR”

5.1 Krijimi i Platformës “Lagja Ime”

Krijimi i Platformës “Lagja Ime” do të mundësojë që qytetarët të kenë qasje online dhe të vendosin se si duhet të përpilohet dhe ndahet buxheti i Komunës. Qytetarët do të mund, përmes e-votimit, të përcaktojnë dhe të zgjedhin vetë projektet prioritare. Qytetarëve do t’u mundësohet që, nëpërmjet përditësimeve me mjete digjitale, të përpilojnë buxhetin dhe të krijojnë një infografikë publike ose “shportë projektësh” sipas preferencave të tyre. Kjo do të rrisë angazhimin lokal dhe pronësinë e lagjeve për zhvillimin e tyre.

5.2 Qëndrueshmëri teknologjike dhe qasje për të gjithë:

Iniciativa për Wi-Fi publik, programe për lehtësimin e aksesit dixhital për komunitetet e marginalizuara, duke përfshirë edhe trajnimin digjital.

5.3 Infrastrukturë teknologjike publike Tele-Qendra “common service centres”:

Pika fizike për akses në internet dhe shërbime dixhitale për ata që nuk kanë pajisje ose lidhje interneti në shtëpi.

5.4 Sisteme të integruara me GIS dhe arkiva digjitale:

Akses dixhital për të dhënat mbi pronat, planifikimin hapësinor dhe dokumentet komunale, i disponueshëm për stafin dhe qytetarët.

Shtylla IV:

Planifikim Urban, Arkitektura dhe Infrastruktura

Pamja e një qyteti tregon shumë për identitetin dhe zhvillimin e tij. Gostivari, me pozicionin strategjik, historinë e pasur dhe komunitetin e larmishëm, meriton një plan urban modern, infrastrukturë funksionale dhe arkitekturë që ruan karakterin e tij, por shikon drejt së ardhmes. Pa këto elemente, çdo zhvillim ekonomik dhe social mbetet i kufizuar dhe i përkohshëm.

Planimetria është mënyra se si organizojmë hapësirën publike, lagjet, ndërtesat, trafikun dhe hapësirat e gjelbra. Pa një plan të qartë dhe profesional, qyteti rritet në mënyrë kaotike, pa standarde, duke sjellë ndotje, bllokime trafiku, mungesë hapësirash për këmbësorët dhe ndjenjë pasigurie urbane.

Arkitektura nuk është vetëm çështje estetike ajo përcakton mënyrën se si jetojmë dhe ruajmë kujtesën kolektive. Kemi nevojë për një kulturë ndërtimi që harmonizohet me natyrën dhe hapësirën, mbështet zhvillimin ekonomik, nxit identitetin vendas dhe promovon arkitekturën bashkëkohore në shërbim të komunitetit.

Infrastruktura: rrugët, uji, kanalizimet, ndriçimi publik, trotualet dhe transporti janë shtylla e çdo qyteti të dinjitetshëm. Duhet të bëjmë investime të mençura, të qëndrueshme dhe transparente, që shërbejnë çdo lagjeje dhe çdo qytetari, jo vetëm qendrës.

Gostivari meriton të jetë një qytet i planifikuar, i ndërtuar me kujdes dhe i pajisur me infrastrukturë që përmirëson jetën e përditshme. Kjo nuk është vetëm çështje teknike është vizion për të ardhmen, respekt për qytetarin dhe themel për çdo zhvillim tjetër.

Problemet kryesore

❖ **Planimetria konfuze dhe e vetë-rregulluar e qytetit:**

Gostivari nuk ka një plan të detajuar urbanistik që përcakton planimetrinë e zhvillimit të qytetit, duke vendosur zonat biznesore dhe industriale, zonat e banimit kolektiv, zonat elitare dhe ato me interes publik. Aktualisht, ndërtimet janë konfuze, pa një strukturë të qartë për vendndodhjen e shtëpive individuale, zonave të banimit kolektiv dhe qendrës së qytetit si qendër ekonomike dhe financiare.

❖ **Keq-menaxhimi me mbeturinat:**

Vendet jo-adekuate për asgjësimin e mbeturinave, hedhja e paligjshme në natyrë, rreziku i infeksioneve dhe katastrofat ekologjike përbëjnë sot një nga problemet më serioze, duke e shndërruar territorin e Gostivarit në një nga zonat më të ndotura në rajon. Aktualisht, mungojnë kosha për mbeturinat e vogla të rrugës, mungojnë kontenjerët familjarë, si dhe ato të posaçme për mbeturinat industriale e biznesore. Komuna nuk ka një strategji apo sistem funksional për seleksionimin e mbeturinave, siç aplikohet në çdo qytet të zhvilluar, ku ato ndahen sipas kategorive (letër, PET, materiale të tjera), duke e bërë më të lehtë grumbullimin, riciklimin dhe trajtimin e tyre.

❖ **Trajtim jo-adekuat i punonjësve të higjienës:**

Orare të zgjatura, mungesë e veshjeve adekuate për ruajtjen e higjienës personale gjatë grumbullimit të mbeturinave, paga të ulëta dhe të prapambetura (61.4 milion denarë)¹ janë disa nga problemet kryesore që përballen punonjësit e terrenit. Këto kushte çojnë në demotivim dhe mungesë angazhimi të atyre që janë përgjegjës për pastërtinë e qytetit.

❖ **Mekanizëm i vjetëruar dhe plotësisht i amortizuar:**

Imagjinoni! Sot, një komunë e tërë që shtrihet në 514 km² dhe përfshin 35 vendbanime (1 qytet dhe 34 fshatra), ka në funksion vetëm një kamion për grumbullimin e mbeturinave. Ky kapacitet i kufizuar e bën të pamundur mbledhjen në kohë dhe në sasi të nevojshme, duke e kthyer gjithë komunën në një deponi të madhe mbeturinash.

¹ Raportit Vjetor të Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2024

❖ **Deponia rajonale “Rusino” punon jashtë çdo standardi:**

Rusino funksionon pa leje mjedisore të integruar (A-IED) nga Ministria e Mjedisit dhe nuk ka përmbushur kriteret ligjore për një land-fill sipas standardeve evropiane. Kjo e bën deponinë të punojë jashtë çdo norme mjedisore, duke rrezikuar shëndetin e qytetarëve dhe ekosistemin e rajonit.

❖ **Ajri i ndotur dhe produkte bujqësore të helmua nga deponia Rusino:**

Për shkak të menaxhimit të dobët të deponisë Rusino dhe djegieve të vazhdueshme të mbeturinave, helmohet jo vetëm popullsia, por edhe produktet bujqësore të zonave përreth, veçanërisht në fshatin Banjicë, ku banorët varen nga kultivimi i disa kulturave bujqësore.

❖ **Mungesa e kolektorëve dhe filtrave për ujërat e zeza në vitin 2025:**

Edhe në vitin 2025, Gostivari nuk ka ndërtuar kolektorë apo stacione filtrimi për ujërat e zeza, të cilat për pasojë përfundojnë të derdhen direkt në lumin Vardar. Kjo situatë është e papranueshme për një qytet evropian në shekullin 21.

❖ **Mungesa e vendeve të parkingut:**

Sipas të dhënave kombëtare (2018), në Maqedoninë e Veriut ka rreth 195 automjete për çdo 1,000 banorë. Me popullsinë e Gostivarit, kjo do të thotë rreth 13,000 vetura në sezon të zakonshëm dhe mbi 30,000 gjatë sezonit kur rikthehen qytetarët nga diaspora. Megjithatë, Gostivari ka vetëm 840 vende parkingu, një proporcioni që është plotësisht i pabalancuar, ku disa parkingje mbajnë deri në 35 automjete.

❖ **Ujë në sasi të pamjaftueshme në disa lagje dhe fshatra të Gostivarit:**

Gati të gjitha fshatrat e Gostivarit vuajnë nga mungesa e ujit të pijshëm, por më të rrezikuara janë Banjica, Debreshi, Çegrani, si dhe disa lagje të veçanta në qytet. Kjo mungesë buron nga keqmenaxhimi i ujësjellësit.

Kapaciteti i burimit kryesor, lumi Vardar, është 415 litra për sekond, por 75% e këtij ujit humbet për shkak të gypave të amortizuar të ujësjellësit, duke lënë vetëm 104 litra për sekond për qytetarët. Gjatë sezonit të verës, kur konsumi rritet, ujë nuk mjafton as për nevojat bazë të familjeve dhe komuniteteve.

❖ Qentë endacakë:

Vlerësohet se në komunë ka rreth 1,000 qen endacakë, shumica në qytet dhe pjesa tjetër në zonat rurale, të cilët janë kthyer në banorë të përhershëm të qytetit, duke zënë hapësira të përdorura nga njerëzit. Në vitin 2023, në territorin e komunës së Gostivarit janë regjistruar 94 raste sulmesh, nga të cilat 63 në qytet dhe të tjerat në fshatra. Numri i sulmeve është trefishuar krahasuar me vitin paraardhës, duke shkaktuar shqetësim dhe ndjenjën e pasigurisë tek qytetarët, veçanërisht gjatë orëve të mëngjesit dhe mbrëmjes, kur fëmijët lëvizin për në shkollë. Qentë endacakë përbëjnë një rrezik konstant për të gjithë qytetarët e Gostivarit, pasi kanë zaptuar çdo hapësirë publike të qytetit.

5 Projektet e Shtyllës IV:

Planifikim Urban, Arkitektura dhe Infrastruktura



I. Aprovimi i Planit Gjeneral dhe Planit Detal Urbanistik

1.1 Plani I Detajuar Urbanistik:

Një qytet duhet të ketë një plan urbanistik që mundëson zhvillimin e planimetrisë së tij në përputhje me nevojat ekonomike, infrastrukturore dhe shoqërore. Gjatë mandatit tim, do të sjellim planet e detajuara urbane për të rregulluar planimetrinë e qytetit. Do të planifikojmë hapësira të veçanta për banimet kolektive, me qëllim organizimin më të mirë të shërbimeve publike. Në partneritet me sektorin privat, do të rregullojmë ndërtimin e lagjeve elitare, duke siguruar zhvillim të balancuar në nivele të ndryshme të jetës qytetare. Për më tepër, do të planifikojmë jetën biznesore dhe tregtare në qendër të qytetit, sipas shembujve të qyteteve evropiane dhe botërore, ku truri ekonomik dhe financiar i qytetit ndodhet në qendër, ndërsa zonat e banimit dhe hapësirat për punë dhe biznes zhvillohen në mënyrë të organizuar dhe të rregullt. Kjo do të mundësojë ndarjen e qartë mes banimit dhe aktiviteteve ekonomike, duke shërbyer zhvillimit të qëndrueshëm të qytetit.

II. Transformimi në Hapësirë Urbane: "Gostivari i së Ardhmes"

2.1 Ndërtimi i Qendrës së Qytetit "Tregu i Vogël i Qytetit":

Sheshi nuk duhet të kthehet në parking, por në hapësirë publike të gjallë dhe të pastër. Futja e veturave në shesh ka sjellë kaos urban dhe ndotje të panevojshme. Prandaj, gjatë mandatit tim, qasja e veturave në shesh do të mbyllet plotësisht.

Zgjidhja do të jetë funksionale: do të ndërtojmë një parking nëntokësor me 3 kate nën shesh, duke i ofruar qytetarëve dhe vizitorëve hapësira të mjaftueshme parkimi. Në këtë mënyrë, sheshi do të kthehet tërësisht në një hapësirë sociale për qytetarët, fëmijët dhe familjet; një vend për të kaluar kohë së bashku, për aktivitete kulturore dhe për të gjallëruar jetën urbane të Gostivarit.

Rrugët dytësore që të sjellin në shesh (Rruga e Dibres, e Kinemasë, e Sahatit, etj.) do të rregullohen me shetitore, ku secila prej tyre do të ketë një pamje të veçantë nga tjetra, duke marrë tematikën e duhur në përputhje me zhvillimin e tyre.

Ndërkohë, sipas modelit të Korçës apo edhe qytetit të Tiranës, në zemër të Gostivarit duhet të ndërtohet tregu i vogël i qytetit, me një pamje krejtësisht të re dhe moderne. Ky treg do të ketë hapësira për aktivitete shoqërore dhe kulturore, duke u shndërruar në pikën kryesore turistike të qytetit dhe në një hapësirë të gjallë për qytetarët dhe vizitorët.

2.2 Pishinë e Mbyllur dhe Aqua Park i Qytetit:

Në partneritet me sektorin privat, Komuna do të përcaktojë parcelën ku do të ndërtohet Aqua Parku, i cili do të përfshijë një pishinë të hapur dhe një pishinë të mbyllur. Investitori do të përfshihet përmes një modeli koncesioni, ku toka do të jepet me afat të caktuar, ndërsa prona dhe investimi do të kthehen në shërbim të komunitetit duke krijuar hapësira publike, ambiente për aktivitete të komunës dhe zhvillim projektësh sipas planit urbanistik.

Pishina e mbyllur do të jetë në shërbim të arsimit dhe sportit, duke u lidhur me të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të qytetit, në mënyrë që noti të futet si lëndë e detyruar në programet shkollore. Nga ana tjetër, pishina e hapur do të jetë në dispozicion të qytetarëve gjatë verës dhe ditëve të nxehta, duke ofruar hapësira moderne rekreative për familjet dhe të rinjtë.

Ky projekt do të kthehet në një qendër sportive, sociale dhe turistike për Gostivarin, duke gjallëruar jetën e qytetit dhe duke tërhequr vizitorë nga rajoni.

2.3 Ndërtesa Kolektive të Ndryshuara Totalisht:

Ndërtesa kolektive dhe transformimi i hapësirës urbane - Gostivari ka ende ndërtesa kolektive që nuk kanë ndryshuar pamjen prej dekadash: fasadat gri, dritaret e vjetra dhe mungesa e ngjyrës e kanë kthyer qytetin në një hapësirë të

zymtë që ende reflekton periudhën e ish-Jugosllavisë. Kjo gjendje nuk pasqyron as dinamizmin e qytetarëve, as potencialin modern të Gostivarit.

Në partneritet me sektorin privat të ndërtimit, diasporën dhe studiot arkitektonike më të njohura të qytetit, do të propozojmë një projekt gjithëpërfshirës për ndryshimin e fasadave, përfshirë ndërrimin e dritareve të vjetra, përdorimin e ngjyrave moderne dhe modelimin arkitektonik që i jep ndërtesave një identitet të ri. Ky proces do të nisë nga zonat më të dukshme të qytetit (si Maleadrid dhe tregu i qytetit), për të krijuar një efekt transformues dhe model zhvillimi për gjithë lagjet e tjera.

Përveç rinovimit të fasadave, mbi çatitë e këtyre ndërtesave do të vendoset një ekosistem i vogël ujitjeje për mini-parqe të gjelbra, duke e bërë çdo ndërtesë jo vetëm më funksionale, por edhe më miqësore me natyrën. Hapësirat përreth ndërtesave do të rregullohen si kopshte dhe mini-parqe, të cilat do të jenë në shërbim të banorëve dhe gjithë qytetarëve.

Parkingjet nëntokësore - Një nga problemet më të mëdha të qytetit është mungesa e parkingjeve. Sipas planit të fizibilitetit, Gostivarit i duhen parkingje nëntokësore dhe jo në kate, pasi mungesa e hapësirave të reja horizontale e bën të pamundur ndërtimin tradicional. Për këtë arsye, do të ndërtohen katër parkingje nëntokësore (nga një për çdo mandat), duke shtuar të paktën 400 vende të reja parkimi, pa shkaktuar kaos urban dhe pa cenuar hapësirat publike ekzistuese.

Ky transformim do t'i japë Gostivarit një fytyrë moderne, të gjallë dhe funksionale, duke e bërë qytetin më të bukur dhe më të jetueshëm për çdo qytetar.

III. Përmirësimi i Infrastrukturës Komunale “Jeta me Dinjitet”

3.1 Menaxhimi i Mbeturinave:

Mbeturinat janë sfida kryesore e komunës. Gjatë mandatit 4-vjeçar, do të realizojmë studim fizibiliteti për vendosjen e pikave të mbledhjes për mbeturinat vogla, rezidenciale, biznesore dhe industriale. Përpunimin e mbeturinave sipas kategorisë dhe madhësisë së tyre. Rehabilitimin e deponisë ekzistuese dhe vendosjen e monitorimit 24/7 me kamera për të parandaluar deponitë e egra dhe për të kontrolluar menaxhimin e mbetjeve.

Ky plan do të sigurojë një qytet më të pastër dhe më të sigurt për qytetarët.

3.2. Përmirësimi i Rrjetit të Ujit të Pijshem:

Gostivari ka nevojë për një furnizim të qëndrueshëm prej 300 litrash/sekondë për të gjithë territorin e komunës. Në bashkëpunim me fondet zvicerane dhe ato të BE-së, do të përfundojmë rrjetin e ujësjellësit, duke siguruar ujë të pastër dhe të mjaftueshëm për të gjitha lagjet dhe fshatrat.

IV. Qasje e lehtë për të marginalizuarit “Gostivari i të gjithëve”

4.1 Krijimi i Një Modeli Inkluziv për Qytetin- Jo Ekskluziv

Komuna do të krijojë disa mekanizma për të lehtësuar jetën e grupeve më të marginalizuara sic janë personat me aftësi të posaçme, pensionistë dhe grupe etnike të pakicave. Për grupe të personave me aftësi ndryshe do të punojmë me institucione publike përfshirë edhe komunën që të krjohen lehtësira në investime infrastrukturore që qasja në vendin e punës të jetë më e lehtë për ata siç janë instalimi i platformave dhe lifteve të posaçme për ta.

Për pensionistët do të punojmë me asociacionet e veçanta për të finansuar aktivitetin e asociacionit me qëllim që jeta e tyre të jetë më cilësore dhe përmbajtsore në qytet.

V. Krijimi i Programit “Gostivari Kujdeset”

5.1 Platformë për Nevojat Qytetare:

Meqë Gostivari po bëhet qytet i pensionistëve, Komuna në partneritet me kompanitë private do të krijojë një platformë web për të ofruar shërbime ushqimore, mirëmbajtjeje dhe të tjera për këtë kategori, pasi mosha e tretë shpesh mbetet e lënë në harresë nga të rinjtë që kanë emigruar në Perëndim. Në bashkëpunim me supermarkete, restorante, kuzhina popullore dhe biznese për mirëmbajtjen e shtëpive, shërbimet do të jenë të listuara në platformë, në mënyrë që fëmijët e tyre ose vetë ata të zgjedhin paketën mujore të shërbimeve që dëshirojnë.

5.1 Program Javor Shoqëror:

Përveç shërbimeve jetësore, Komuna, në partneritet me Ministrinë e Çështjeve Sociale, do të nisë programin e vet për ofrimin e shërbimeve sociale, si shëtitjet ose bisedat me të moshuarit, ku çdo punonjës social do të shoqërojë të paktën një pensionist një herë në javë për minimum një orë, sipas nevojave të tyre.

Shtylla V:

Trashëgimia Kulturore, Turizmi dhe Diaspora

Gostivari nuk është thjesht një qytet, është histori, kulturë, traditë dhe shpirt komunitar. Ai është një pikëtakim i kulturave, besimeve dhe identiteteve që kanë bashkëjetuar për shekuj. Ndërsa shumë qytete përpiqen të krijojnë identitet, Gostivari tashmë e ka por rrezikon ta humbasë, nëse nuk e mbrojmë, zhvillojmë dhe lidhim me të ardhmen.

Trashëgimia kulturore është kujtesa jonë kolektive shtëpitë e vjetra, rrugicat e lagjeve tradicionale, zakonet, artizanati dhe mënyra se si jetojnë gjeneratat e vjetra. Ruajtja e saj duhet të jetë prioritet i çdo qeverisjeje lokale, sepse pa rrënjë nuk ka qëndrueshmëri. Turizmi, i lidhur ngushtë me trashëgiminë, është një mundësi reale për zhvillim ekonomik dhe promovim ndërkombëtar. Gostivari ka potencial të bëhet destinacion atraktiv për vizitorë vendas dhe të huaj, por mungon organizimi, investimi dhe vullneti për ta kthyer këtë potencial në realitet.

Diaspora është pasuria jonë shpirtërore, ekonomike dhe shoqërore. Lidhja me të nuk duhet të kufizohet vetëm në festa ose vizita verore, por të shndërrohet në bashkëpunim afatgjatë për investime, projekte kulturore, edukim dhe shkëmbim përvojash.

Trashëgimia, turizmi dhe diaspora janë zemra e gjallë e Gostivarit aty ku rrënjët, potenciali dhe lidhjet emocionale bashkohen për të ndërtuar një të ardhme me dinjitet, vetëbesim dhe prosperitet. Pa to, jemi thjesht një qytet. Me to, jemi një komunitet me shpirt, histori dhe vizion.

Problemet kryesore

❖ **Mos shfrytëzim i potencialit:**

Edhe pse qyteti është vendi ku kalon lumi Vardar dhe rrethohet nga shumë male, me një potencial të lartë për zhvillimin e agro-bizneseve. Ky potencial mbetet i pashfrytëzuar për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe vizionit për ta kthyer hapësirën komunale në një zonë zhvillimi agro-biznesi, ku prodhimi ushqimor lidhet me turizmin.

❖ **Fokusi jo në fondet e huaja:**

IPARD është një program i posaçëm i BE-së për të financuar projektet agrare në zonat rurale ose të pazhvilluara, dhe Komuna nuk bën as identifikimin e fondeve, as informimin e bizneseve për këto mundësi.

❖ **Partneritet i munguar me komunën:**

Bujqit dhe fermerët akoma nuk kanë krijuar një platformë bashkëpunimi me qëllim që të krijohet një identitet për këto biznese “*Made in Gostivar*”. Kjo ndodh për shkak të mungesës së vizionit, kapaciteteve për të absorbuar këto fonde, si dhe menaxhimit të tyre.

5 Projektet e Shtyllës V:

Trashëgimia Kulturore, Turizmi dhe Diaspora



I. Mbështetje për Bujqësinë: “Nga Ara në Treg, Gostivari Prodhon!”

Trendi rajonal i lidhjes së produkteve vendore ushqimore, zejeve tradicionale dhe pasurive natyrore të komunës, të kthyer në AGRO-BIZNESE, do të përkrahët fuqishëm nga Komuna, duke i kthyer bizneset në promovim të ushqimeve tradicionale, zanateve të zonës dhe bukurive të Gostivarit si trademark ose vulë mbrojtëse të qytetit. Gostivari ka lumin Vardar, bukuri malore të rralla dhe diell mbi 80% të kohës, që janë parakusht për mbështetjen e agro-bizneseve vendore. Si Komunë do të lidhim këtë edhe me përpunuesit e ushqimit, frutave të malit dhe perimeve të zonës, shumë të harruara deri tani. Komuna do të krijojë një paketë financiare (subvencione, infrastrukturë të ndërtuar, mospagesë të tatimeve lokale për një vend) dhe jo-financiare (trajnime, këshillime, informime) për të gjithë prodhuesit dhe përpunuesit e produkteve ushqimore në vend.

1.1 Kooperativa lokale e Bujqësisë:

Krijimi i një kooperative që bashkon fermerët lokalë, duke garantuar tregtinë e prodhimeve, përmirësuar negociatat për çmime më të mira dhe siguruar stabilitet financiar për ta.

1.2 Agro-Qendra për Trajnim dhe Këshillim:

Hapja e një qendre komunale që ofron trajnime profesionale falas, këshilla agronomike dhe mbështetje teknologjike për fermerët e Gostivarit, duke prezantuar metoda moderne të prodhimit.

1.3 Markë okale “Prodhuar në Gostivar”:

Zhvillimi i një marke lokale për prodhimet bujqësore dhe organike të Gostivarit, duke krijuar një brend unik që rrit konkurrencën dhe dukshmërinë në tregjet vendore dhe rajonale.

1.4 Tregu i Agrobiznesit Lokal:

Ndërtimi i një tregu të përhershëm dhe modern në Gostivar, ku fermerët do të shesin direkt produktet e tyre, duke ulur kostot dhe rritur fitimet për prodhuesit.

II. Agro-Turizmi si Destinacion Turistik

2.1 Gostivari Agroturistik “Shijo Natyrën, Shijo Traditën:

Rruga Agroturistike e Gostivarit: Krijimi i një rruge turistike të organizuar dhe të shënuar qartë që lidh fermat lokale, restorantet tradicionale dhe vendet natyrore më të bukura në rajonin e Gostivarit.

2.2 Gostivari gastronomik:

Evente mujore dhe panaire vjetore gastronomike ku restorantet dhe lokalet promovojnë ushqimet tradicionale, produktet organike dhe specialitetet e zonës, duke tërhequr turistë nga rajoni dhe diaspora.

III. Rigjallërimi i Traditave të Gostivarit

3.1 Platformë Digjitale “Vizito Gostivarin”:

Promovimi digjital i ofertave turistike-agrare, me guida, harta interaktive dhe mundësi rezervimi direkt të përvojave turistike dhe gastronomike.

IV. Festivalet si Koncept Turistik

4.1 Përkrahja e Festivaleve Lokale Ekzistuese

Kohët e fundit është bërë trend organizimi i festivaleve tradicionale në fshatrat e Gostivarit, me qëllim promovimin e kulturës, zakoneve dhe traditave të këtyre zonave. Komuna do të krijojë një kalendar të rregullt të këtyre ngjarjeve dhe, në mënyrë të organizuar, do të promovojë bukuritë natyrore, ushqimin dhe zejet karakteristike të rajonit.

4.2 Krijimi dhe organizimi i festivaleve ndërkombëtare

Përveç festivaleve lokale, Komuna, në bashkëpunim me operatorë privatë dhe organizata joqeveritare, do të organizojë një festival unik, i cili nuk ka ekzistuar më herët në Maqedoni. Qëllimi i këtij festivali do të jetë tërheqja e investitorëve dhe turistëve të huaj, duke u ofruar atyre mundësinë që të promovojnë kulturën tonë edhe në vendet e tyre të origjinës.

V. Trajnimi dhe Këshillimi i Bizneseve Bujqësore

5.1 Mbështetje financiare për fermerët e rinj:

Krijimi i një fondi për fermerët e rinj që dëshirojnë të nisin agrobiznese të reja, duke u ofruar grante fillestare dhe lehtësira për blerjen e pajisjeve, ndërtimin e serave dhe instalimin e sistemeve moderne të ujitjes.

5.2 Mbështetje për fermat turistike:

Komuna do të mbështesë fermerët që dëshirojnë të hapin ferma turistike, duke u ofruar lehtësira investimi për ndërtimin e ambienteve akomoduese tradicionale dhe hapësirave për degustimin e produkteve ushqimore lokale.

5.3 Trajnime për menaxhimin e agroturizmit:

Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive profesionale falas për banorët lokalë, me qëllim rritjen e kapaciteteve për menaxhim efikas të bizneseve agroturistike dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve turistike në Gostivar.

Parimet Themelore:

Partneritet me Qytetarët

Qytetarët si bashkëkrijues të zhvillimit lokal.

Transparencë

Të gjitha vendimet, punësimet, emërimet, buxhetet dhe tenderët do të jenë të hapura për publikun.

Llogaridhënie

Raporte të rregullta, auditime dhe anketa të kënaqësisë së qytetarëve.

Gjithëpërfshirje

Përfshirja e grave, të rinjve, pakicave dhe grupeve të marginalizuara.

Sundimi i Ligjit

Kode etike dhe tolerancë zero ndaj korrupsionit, brenda kompetencave dhe autoritetit të pushtetit lokal: miratimi dhe zbatimi i planeve urbanistike, menaxhimi i buxheteve, ofrimi i shërbimeve komunale, si dhe udhëheqja me arsimin fillor, të mesëm dhe institucionet parashkollore.

Parakushtet për Bashkëqeverisje me Qytetarët

Korniza Ligjore dhe Institucionale

- ❖ Ndryshime statutores për të formalizuar pjesëmarrjen qytetare.
- ❖ Formimi i Këshillave Qytetare me rol këshillues.

Ndërtimi i Kapaciteteve

- ❖ Trajnime për nëpunësit komunalë mbi transparencën dhe pjesëmarrjen.
- ❖ Programe për edukim qytetar dhe aftësi digjitale.

Mjete dhe Mekanizma

- ❖ Buxhetim pjesëmarrës.
- ❖ Forume publike dhe platforma online për propozime dhe ankesa.

(Platformë për ankesa: Brenda 24 orëve qytetari merr përgjigje se ankesa është regjistruar. Brenda 72 orëve bëhet analiza e parë dhe jepet përgjigje qytetarit për problemin dhe parashikimi për kohëzgjatjen dhe mënyrën e trajtimit. Brenda 5 ditëve jepet përgjigje e saktë për mënyrën e trajtimit. Qytetari, në çdo moment, mund të informohet për statusin e lëndës së tij.)

- ❖ Kartela vlerësimi nga qytetarët për shërbimet.

Infrastrukturë për Transparencë

- ❖ Portali i transparencës së Komunes së Gostivarit.

(Të gjitha vendimet, tenderimet, emërimet, punësimet dhe justifikimet për vendimet do të shpallen në portal.)

- ❖ Seanca të hapura të këshillit me mundësi për komente.

Si Do Ta Realizoj Programin?

Vullnet Administrativ

- ❖ Do të nënshkruajmë Kartën për Partneritet Qytetar, e nënshkruar nga kryetari i komunës.
- ❖ Samite vjetore qytetar-komunë për vlerësimin e progresit.

Si do ta mbikëqyrim partneritetin dhe si do ta vlerësojmë?

- ❖ Do të formojmë Njësi të Pavarur për Monitorimin e Transparencës.
- ❖ Do të publikojmë raporte vjetore të performancës.
- ❖ Do të krijohet Zyra Lokale e “Avokatit të Popullit” për ndërmjetësim, për çështje që janë në kompetencë të pushtetit lokal. “Avokati” ose lista e kandidatëve do të propozohet dhe zgjidhet nga bashkësitë lokale.

Vitin e parë e pilotojmë, pastaj e zgjerojmë

- ❖ Fillojmë me iniciativa pilot në një bashkësi lokale.
- ❖ Zgjerimi do të bazohet në rezultatet dhe reagimet.

Bashkëpunim

- ❖ OJQ-të si ndërmjetës dhe monitorues.
- ❖ Bashkëpunim me universitete dhe donatorë ndërkombëtarë.

Rezultatet deri më 2030

- ❖ Pjesëmarrje e garantuar e qytetarëve në buxhetim.
- ❖ Rritje e besimit në pushtetin lokal për 50%.
- ❖ Kënaqësi më e madhe nga shërbimet. (Me kalimin e kohës, qytetarët do të jenë më të kënaqur.)
- ❖ Përmirësim i indeksit të transparencës.

Thirrje Për Mbështetje

Zgjedhjet nuk janë vetëm për të zgjedhur një kryetar komune.

Janë një mundësi për të zgjedhur një drejtim të ri.

Për të zgjedhur ndershmëri, përkushtim dhe punë konkrete.

Nëse ndiheni **të papërfaqësuar**.

Nëse jeni **të lodhur** nga premtimet boshe.

Nëse doni **një kryetar që ju dëgjon dhe ju respekton**.

Atëherë **bashkohuni me mua**.



VOTONI: VISAR ADEMI- KANDIDAT I PAVARUR
VOTONI PËR "GOSTIVARI ME VISARIN"



Ejani bashkë ta ndërtojmë qytetin që na përfaqëson të gjithëve!

Kontakt



info@mevisarin.mk



www.mevisarin.mk



[@ademi.visar](https://www.instagram.com/ademi.visar)



[Visar Ademi](https://www.facebook.com/visar.ademi)

GOSTIVAR

